



---

**AKT THEMELIMI**  
**"Pret a Porter" SHPK**

- **Emi Canaj**, shtetase shqiptare, lindur më 18.06.1991, në Tiranë dhe banuese në Tiranë, mbajëse e Pasaportës me Nr. BR7070378 dhe Nr. Personal J15618050C.

*E angazhuar për të themeluar një shoqëri të re tregtare në Shqipëri, duke kuptuar plotësisht legjislacionin Shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare si dhe duke patur në dispozicion të gjitha mjetet e nevojshme financiare si dhe idetë për të themeluar një biznes, nëpërmjet këtij akti, të hartuar dhe nënshkruar sot më datë 21.01.2020, shprehin vullnetin e tyre të lirë dhe angazhimin për të themeluar një "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar", si vijon:*

**1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë.**

Emri i shoqërisë do të jetë **"Pret a Porter" SHPK**, e quajtur më poshtë me emrin "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

**2. Ortakët e shoqërisë.**

Ortaku i vetëm është:

- **Emi Canaj**, shtetase shqiptare, lindur më 18.06.1991, në Tiranë dhe banuese në Tiranë, mbajëse e Pasaportës me Nr. BR7070378 dhe Nr. Personal J15618050C.

**3. Objekti i veprimtarisë.**

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

- Veprimtari në fushën e kulturës dhe publicitetit si në organizimin e ekspozitave, spektakleve, eventeve të ndryshme, dasmave, realizimin e shtypit, fotografise, filmit etj.
- Tregtimin e mallrave brenda vendit dhe të import-eksport me shumicë e pakicë, si ushqimore e jo ushqimore, industriale, tekstile, lënde të para e gjysëm të përpunuara, prodhime elektroshtepiake, shërbime estetike dhe tregeti të përgjithshme jo kirurgjikale etj.
- Aktivitet në fushën e veshmbathjes si dhe aksesoret e saj, prodhim i përpunuar dhe jo i përpunuar i aksesoreve, pakicë dhe shumicë i veshmbathjeve dhe aksesoreve si dhe qiradhënia e tyre.
- Aktivitet në fushën e botimeve të ndryshme si libra, gazeta, revista, CD dhe materiale të tjera publitare. Prodhim, shpërndarjen dhe riprodhim reklamash dhe të tregtisë së aksesoreve të kompjuterave. Shoqëria mund të kryejë dhe projektimin, zhvillimin, krijimin dhe asistencën të çdo dhe cildo produkti të përdorur për mobilim, pajisje apo ndërtim shtepiak, tregtar apo industrial, si për vete shoqërine ashtu edhe për të treta; dhe për zhvillimin e aktiviteteve tregtare dhe industriale të llojit.
- Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, të blejë dhe të shesë ose marrë me qira ndërmarrje, dege ndërmarrjesh, si dhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsociume, të themeluara apo në themelim të sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithësesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë..

---

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

**4. Selia e shoqërisë.**

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Rruga " Vaso Pasha", P11.13/1, Tirane, Shqipëri;**
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

**5. Kohëzgjatja e shoqërisë.**

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është i **pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**6. Kapitali themeltar.**

- Kapitali themeltar i shoqërisë është **100 000 All (njëqind mijë).**
- *Ortaku, **Emi Canaj** zotëron **100 %** të kuotës në kapitalin themeltar, ose 1 (një) kuotë, me vlerë nominale **100 000 All (njëqind mijë).***

**7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë.**

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

**8. Administratori**

Administratori emërohet për një mandat 5 (pese) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.

Administratori i parë shoqërisë do të jetë:

- **Emi Canaj**, shtetase shqiptare, lindur më 18.06.1991, në Tiranë dhe banuese në Tiranë, mbajëse e Pasaportës me Nr. BR7070378 dhe Nr.Personal J15618050C.

**9. Likuidimi i shoqërisë**

Në rast falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

**ORTAKU I VETEM**

**Z. Emi Canaj**

*Emi Canaj*  
*Emi Canaj*

Date **21.01.2020**

**REPUBLIKA E SHQIPËRËSË**  
**DHOMA E NOTERËVE TIRANË**



Nr. 246 Rep

**VERTETIM**

Sot më date 21.01.2020, para meje noteres Ardjana A.MEDIU, me seli ne adresen: Blv. Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 7, Tirane, u paraqit personalisht;

Znj.**Emi Canaj**, shtetase shqiptare, lindur më 18.06.1991, në Tiranë dhe banuese në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike per te vepruar e identifikuar prej meje me Pasaportë Nr. BR7070378 dhe Nr.Personal J15618050C.

**E cila më deklaroi se:**

Dokumentin bashkengjitur këtij akti, **Akt Themelim i Shoqërisë "Pret a Porter" Sh.p.k, date 21.01.2020**, e ka hartuar jashtë kësaj zyre noteriale me vullnetin e saj të lirë dhe të plotë dhe e nënshkroi atë në prezencën time. Unë noterja pasi e gjej konform ligjit e vërtetoj atë rregullisht.

**NOTERE**  
**Ardjana A.MEDIU**

adresa: Blv."Deshmoret e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kat 7-Tirane

